



Albano Bushi
Fajdek



Bleuni
Lice
Tajana Xaus

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

Nr. 2174 / Prot.
4

Vlorë më, 21 . 11 . 2023

VENDIM
Nr. 58, datë 21.11.2023

PËR
MIRATIMIN E RIAPLIKIMIT TË PROGRAMIT TË RI TË STUDIMIT "MASTER I
SHKENCAVE NË MARKETING DIXHITAL" PËR VITIN AKADEMIK 2024-2025

Në mbështetje të nenit 25, pika 7, nenit 38, pika 1, shkronja dh, nenit 75 të Ligjit nr. 80/ 2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 10, pika 6, nenit 19, pika 1, shkronja ë të Statutit të Universitetit "Ismael Qemali", Vlorë, Udhëzimit nr.1 të MAS datë 14.01.2020, "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e IAL-ve, degëve dhe njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e IAL-ve", VKM nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë" si dhe referuar propozimit të Zëvendësrektorit Akademik ardhur me shkresën 2044/5 prot, datë 20.11.2023 Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 21.11.2023,

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin e Departamentit të Biznesit në Fakultetin e Ekonomisë për riaplikimin e hapjes së programit të ri të studimit "Master i Shkencave në Marketing Dixhital" sipas materialit bashkëlidhur dhe pjesë e këtij vendimi.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Fakulteti i Ekonomisë, Departamenti i Biznesit, Zëvendësrektorit Akademik si dhe Drejtoria e Edukimit të Ciklit të parë dhe të dytë të studimit.
3. Ky vendim i përcillet për miratim të mëtejshëm Bordit të Administrimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
Prof. Dr. Roland Zisë

